



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:061804

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05870036

KF.nr.574/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit “Ardi”, Sh.P.K me numër unik identifikues 810517089 dhe seli në Prishtinë, përfaqësuar me autorizim nga Shoqëria e Avokatëve “SCLR” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekti i kontestit vlerësim doganor, vlera e kontestit 1,788.00 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 19.06.2024 në prani të përfaqësuesit të palës paditëse G.B. dhe përfaqësueses së palës së paditur B.G., mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Ardi”, Sh.P.K me numër unik identifikues 810517089 dhe seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET Aktvendimi me nr. 01.3.2./2525 datë 16.03.2020, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Ardi”, Sh.P.K me seli në Prishtinë, t’ia kthej shumën prej 1,788.00 euro € (një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë euro), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr.R-439/15.01.2020 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore-Prishtinë, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 03.06.2020 deri në pagesën definitive.
- IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi , “Ardi” Sh.P.K nga Prishtina, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 03.06.2020, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë si të bazuar, të anulohet si i pabazuar Aktvendimi 01.3.2./2525 datë 16.03.2020 dhe të detyrohet e paditura që të bëjë kthimin e mjeteve të paguara në emër të detyrimeve doganore në shumën prej 1,788.00 euro. Gjatë seancës së fundit të shqyrtimit kryesor publikë të datës 19.06.2024 përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë kërkesëpadisë dhe pranë të gjitha pretendimeve të paditësit. Ka shtuar se vendimi i të paditurës është jo ligjor për faktin se gjatë vendosjes të kësaj çështje nuk ka vlerësuar drejtë gjendjen faktike dhe nuk ka aplikuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore. Paditësit ka bashkangjitur të gjitha provat e nevojshme me të cilat i mbështet pretendimet e tij, ka bashkangjitur deklaratën doganore kontestuese transaksionet bankare në të cilën janë përfshirë edhe dy DUD-a të tjerë jo kontestues R2890/26.03.2019 dhe R11235/18.09.2019 e të cilat ia dorëzojnë gjykatës edhe pse ato janë në shkresa të lëndës. Me veprimin e të paditurës paditësi ka obliguar të paguajë në shumën prej 1,788.00 euro. Në fund ka shtuar se në këtë konflikt administrativ gjykata e shkallës së dytë e ka kthyer në rishqyrtim pranë kësaj gjykate me arsyetimin se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje. Prandaj i ka rekomanduar të njëjtës të veproj sipas këtij aktgjykimi. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj kërkesëpadinë dhe ta anuloj vendimin e të paditurës dhe ta obligoj të paditurën që t’ia kthej paditësit shumën prej 1,788.00 euro të paguara më tepër në emër të detyrimeve doganore e të gjitha këto me kamatën ligjore me 8% në vit nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare.

E paditura në përgjigje në padi të datës 03.02.2021 dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 19.06.2024 ka deklaruar se e kundërshtojnë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke i propozuar që të njëjtën ta refuzoj si të pa bazë duke lënë në fuqi vendimin e kontestuar si të drejtë dhe të ligjshëm. Më tej ka shtuar se paditësi në fazën e rishqyrtimit të vendimit nuk ka prezantuar dokumentacion për të vërtetuar vlerën reale të transaksionit, ku sikurse është thënë edhe në vendimin e kontestuar i ka munguar deklaratat eksportuese, kontrata e shitblerjes së mallit dhe transferi bankar. Transferi i prezantuar tani edhe në këtë seancë edhe në seancat e kaluara paditësi nuk ka mundur të prezantoj në fazën e rishqyrtimit sepse e njëjta nuk i ka poseduar për doganën e për të cilat transferi i datës

21.01.2020 nuk është paraqit tek e paditura gjatë procedimit administrativ, ndërsa data e lëshimit të vendimit të kontestuar është data 16.03.2020 e që i bie që ky vendim ka qenë në posedim të paditësit, por që nuk është prezantuar te e paditura, andaj dogana ka vepruar drejtë dhe konform dispozitave ligjore kur ka refuzuar kërkesën e paditësit. Po ashtu dogana ka vepruar konform nenit 43 të LKA-së. Gjykatës i ka propozuar të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit dhe të lë në fuqi aktvendimin e kontestuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin A.nr.946/20 të datë 14.07.2021, kishte refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke lënë në fuqi aktvendimin kontestues të Doganës së Kosovës.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, me aktvendimin K.DH.SH.II.135/22 të datës 31.08.2023, ka anuluar aktgjykimin A.nr.946/20 dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 19.06.2024, ka administruar provat si në vijim: Përgjigja në padi e dt.03.02.2021 nga Dogana e Kosovës, Aktvendimi nr.01.3.2.2/2525 i dt. 16.03.2020 i Doganës së Kosovës, fatura e mallit, pagesa bankare, Deklarata Doganore, ankesa e paditësit me nr.prot.2525/18/.02.2020, të dhënat e disponueshme të Doganës së Kosovës.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, duke marr për bazë edhe vërejtjet e dhomave të shkallës së dytë të kësaj Gjykate, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është çmim real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë. Zyra e pranimit ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit është bazuar në metodën e 6 të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, pasi që këto

të dhëna janë marrë nga Sektori i Vlerës, vlerësim ky i cili është bërë duke i shfrytëzuar informatat e dhëna nga zhdoganimet e rregullta nëpër degë. Dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është vlerësuar si provë e pamjaftueshme pasi që i njëjti nuk ka prezantuar deklaratën eksportuese, mungon transferi bankar dhe kontrata e shitblerjes. Andaj në këtë kuptim Dogana e Kosovës nuk mund të bëjë një konstatim tjetër të gjendjes faktike nga gjendja dhe çmimi i përcaktuar nga zyra doganore.

Me Dispozitën ligjore të nenit 33 par 1 të KDAK-së është përcaktuar se “*Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37*”.

Tutje, në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së përcaktohet se “*Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjete tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë*”. Ndërsa, se cilat dokumente duhet ti bashkëngjiten deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është e rregulluar me nenin 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, ku decidivisht përcaktohet se: “*a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti*”.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykatës i rezultoi një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ. Gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në procedurën administrative dhe në këtë konflikt administrativ është i mjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paguar vlerën reale të mallit lëndor.

Gjykata pasi ka analizuar transaksionin bankar dhe faturat e mallit lëndor kontestues, konstaton se transferi bankar është bërë në emër dhe llogari të eksportuesit të mallit “MIKE COMPANY”, ku përmes të dhënave bankare të eksportuesit të paraqitura në faturë është bërë

edhe transferi bankar i datës 21.01.2020, ndërsa në përshkrimin e transferit është shënuar “pagesa e faturës invoice nr.1-171/1-177/1-182 me nr. të DUD-ave R-2890/R-11235/R-439 që përmbajnë Lighter - shkrepa xhepi”.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës rrjedh se në këtë transfer bankar përcaktohen edhe detajet e faturave për DUD-at jo kontestues e të cilat gjenden në shkresat e lëndës e të cilat harmonizohen me këtë transaksionin bankar të datës 21.01.2020.

Pretendimet e të paditurës se dokumentacioni përcjellës i mallit është i pa mjaftueshëm pasi që kontrata e shitblerjes mungon, kjo Gjykatë vlerëson se kontrata e shitblerjes dhe deklarata eksportuese nuk janë dokumente të cilat kërkohen sipas Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës dhe nuk janë dokumente të obligueshme, mirëpo për gjykatën mjafton që të harmonizohen faturat e DUD-ave kontestues me trasnaksionet e pagesave.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-it, R-439/15.01.2020, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtina 3, dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 1,788.00 Euro, mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së.

Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka vërtetuar se pagesa nga fatura nr.1-171 e datës 25.03.2019, fatura nr.1-177 e datës 16.09.2019 dhe fatura 1-182 e datës 06.01.2020, e deklaruar me DUD-in R-439/15.01.2020 është realizuar përmes pagesës bankare me datë 21.01.2020 në emër të këtyre faturave me përshkrimin e numrave të faturave si dhe Dudave doganorë.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se të gjitha dokumentet lidhur me deklaratën unike doganore kontestuese, rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi konform nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata pretendimet e paditësit lidhur me deklaratën unike doganore kontestuese, i vlerësoi si tërësisht të bazuara dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, konform nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ashtu që aprovoi kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'i kthej shumën prej 1,788.00 Euro, të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit jo të drejtë të mallit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e zhdoganuar përmes DUD-it kontestues të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prishtina 3 në shumë prej 1,788.00 euro me kamatë ligjore prej 8 % nga data 03.06.2020, e deri në kthimin e plotë.

Sa i përket kamatës gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, sipas precizimit të kërkesëpadisë nga i autorizuari i paditësit bërë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.05.2024, duke pasur parasysh dispozitën e nenit 292 pika b) (i), të KDAK-së nr.03/L-109, ku parashihet *“Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme”* dhe dispozitat ligjore të nenit 170 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku thuhet se *“Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit”* dhe nenit 382 paragrafi 2 të këtij ligji ku thuhet se *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, ndërsa lidhur me datën e rrjedhës së kamatës sipas kërkesës së palës paditëse ka marrë datën e parashtrimit të paditës, respektivisht datën 03.06.2020.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, gjykata konform nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.574/23, datë 19.06.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.